VENDIM
Nr.156,datë 1.12.2014

MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO)

Mbështetur në nenin 8, pika 2 dhe 9 e ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe neni 25 i Rregullave dhe Procedurave të ERE-s, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për miratim e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Për miratimin e kësaj rregulloreje është marrë opinioni i të gjitha grupeve të interesit duke njoftuar zyrtarisht e publikisht ata. Në cilësinë e vendit anëtar të ECBR-s rekomandohet që rregullatorët kombëtarë anëtarë të saj, ta miratojnë këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) bashkëlidhurkëtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 140, datë 22.11.2013 i Bordit "Për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit".

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojëpersonat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti